



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0304

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Agimi-De SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me kuti arkivuse me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1, me 17/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjesërishtë e bazuar ankesa e OE Agimi-De SH.P.K. me nr. 2025/0304, e datës 28/04/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kuti arkivuse”, me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1, ndërsa (AK) - Komuna e Gjakovës ti mbetet në fuqi vendimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Urdhërohet, autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës konform nenit 30, në emër të dëmit për kompensimin e shpenzimeve procedurale, OE ankues, OE Agimi-De SH.P.K, të paguajë vlerën e përcaktuar sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE OE Agimi-De SH.P.K sipas nenit 31 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.02.2025 Komuna e Gjakovës , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me kuti arkivuse me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 54,000.00 €.

Me 15.04.2025 OE Agimi-De SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 17.04.2025 Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar

Me 28.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Agimi-De SH.P.K. me nr. 0304/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me kuti arkivuse me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Agimi-De SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues (AK)/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat e sipërcekura ligjore si dhe Rregulloren dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik.

AK/Zyra e Prokurimit, më datë 28.03, ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë kompaninë tonë, me çmimin total të ofertës 15,800.00 €.

Më 08.04 është publikuar në platformën e prokurimit elektronik (e-prokurim) njoftimi për dhënie të kontratës, ndërsa më 10.04 AK ka publikuar njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës.

AK ka anuluar dhënien e kontratës për kompaninë tonë me arsyetimin si më poshtë (citojmë):

“Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit për Furnizimi me kuti arkivuese, me numër identifikues 632-25-814-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-25-007-121. Para hapjes, dy operatorë ekonomikë kanë kërkuar sqarime shtesë. Autoriteti Kontraktues, më datë 15.02.2025, ka dhënë sqarime shtesë, të cilat i ka ngarkuar në platformën e e-prokurimit, por nuk ka ngarkuar edhe përmirësimin e përshkrimit të çmimeve. Të gjithë operatorët ekonomikë kanë ofertuar sipas përshkrimit të vjetër të çmimeve, kurse Autoriteti Kontraktues këtë e ka vërejtur pas publikimit të njoftimit për dhënie (B08). Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues është detyruar të bëjë anulimin e dhënies (B08) si e vetmja mundësi.”

Megjithëse nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, AK në mënyrë joligjore ka vendosur të anulojë aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se “përshkrimi i çmimeve nuk është përmirësuar”.

Vetë fakti se AK ka ngarkuar sqarimet shitesë në platformë dhe se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i kanë pranuar ato, nënkupton që këto sqarime janë bërë pjesë përbërëse e dosjes së tenderit dhe çdo OE ofertues është dashur t'u përmbahet atyre.

Sipas dispozitave ligjore, aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet vetëm për një nga arsyet e mëposhtme:

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti Kontraktues duhet të përfundojë aktivitetin e prokurimit që nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga këto arsye:

1.1. Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet kur një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë aktivitetin e prokurimit që nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga këto arsye:

2.1. Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin përkatës;

2.2. Para hapjes së tenderëve, është bërë e nevojshme ndërprerja e aktivitetit të prokurimit për shkak të ngjarjeve objektive dhe të verifikueshme, apo për arsye që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit, por kjo ndërprerje duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Në njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës, AK ka cekur si arsyetim:

IV.4) Arsyeja e anulimit të njoftimit të dhënies së kontratës:

“Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit.”

Ky konstatim i AK nuk qëndron, pasi siç u përmend më lart, pas shpalljes së kompanisë sonë si fituese nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP, e cila do të mund të rezultonte me anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, AK ka sqaruar se ka ndodhur një gabim teknik, pasi aktiviteti i prokurimit është anuluar me arsyetimin se “ka ndodhur ose mund të ndodhë një shkelje ligjore e pariparueshme”.

Në këtë procedurë tenderimi, pas hapjes së ofertave, AK/Zyra e Prokurimit na është drejtuar me kërkesë për informacione shtesë më datë 21.03, ndërsa më 24.03 kemi dorëzuar të gjitha sqarimet e kërkuara.

Nëse AK kishte pasur ndonjë dilemë nëse do ta realizonim projektin sipas ndryshimeve të bëra në dosjen e tenderit më 19.02, ka pasur mundësi të na drejtohej me letër standarde për të konfirmuar nëse do t'u përmbahemi atyre ndryshimeve.

Në rast se ne si kompani, para nënshkrimit të kontratës, do të deklaronim se nuk do t'u përmbahemi ndryshimeve të bëra, atëherë AK do të kishte bazë për të anuluar aktivitetin. Mirëpo, ne kemi ofertuar me vetëdije dhe kemi pranuar kushtet dhe ndryshimet e paraqitura në dosjen e tenderit. Para ofertimit kemi lexuar sqarimet shtesë të publikuara nga AK dhe jemi pajtuar me to, prandaj anulimi i procedurës pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës përbën shkelje të qartë të ligjit.

Pas kalimit të afatit për ankesa, më 04.04 kemi porositur dhe blerë një pjesë të lëndës së parë jashtë vendit, në mënyrë që të përgatitemi për zbatimin me kohë të projektit. Anulimi i procedurës në këtë fazë përbën diskriminim të hapur ndaj kompanisë sonë dhe shkakton dëm financiar, duke na pamundësuar përfitimin e pritur nga kjo kontratë.

Duke marrë parasysh të gjitha faktet e lartcekura, konstatojmë se AK/Zyra e Prokurimit ka anuluar pa bazë ligjore aktivitetin e prokurimit, duke i mohuar kompanisë sonë të drejtën për të përfituar një kontratë publike dhe duke shkaktuar humbje financiare nga mosrealizimi i projektit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 29/04/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0304/2025, ndërsa me datë 07/05/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0304 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues për anulim të vendimit, ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet pjesërisht lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Agimi-De SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0304 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjakovës, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës është 54,000.00 €. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët".

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62, dhe 72.3 të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores për

Prokurim Publik, konkretisht të nenit 38.2, 40 dhe 45 të Rregullores.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave dhe rekomandimit për kontratë. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se AK Komuna e Gjakovës, me datë 28.03.25, ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë OE “AGIMI- DE” Sh.p.k-Decan tani ankues me çmimin total të ofertës 15,800.00 euro. Me datën 08.04.2025, është publikuar në e-prokurim njoftimi për dhënie të kontratës ndërsa me datën 10.04.2025 AK ka publikuar njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës.

AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetim: “.... Para hapjes dy operator ekonomik kanë kërkuar sqarime shtesë AK me datën 15.02.2025, ka bere sqarime shtesë të cilat i ka ngarkuar në platformën e e-prokurimit, por nuk ka ngarkuar edhe përmirësimin e përshkrimit të çmimit. Të gjithë operatorët ekonomik kanë ofertuar me përshkrimin e vjetër të çmimeve, kurse Autoritet kontraktues këtë e ka vërejtur pas publikimit të njoftimit për dhënie(B08). Në këtë pikë Autoritet kontraktues është detyruar të beje anulimin e dhënies (B08) si e vetmja mundësi.”

Tutje OE ankues potencon se asnjë kerkese për ri-shqyrtim nga OE pjesëmarrës nuk ka pas AK jashtëligjshëm ka vendosur të anulojë aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se paramasa –përshkrimi i çmimeve nuk është përmirësuar.

Me vete faktin se AK ka ngritur sqarimet shtesë dhe OE pjesëmarrës kanë pranuar sqarimet shtesë nënkupton se sqarimet janë pjesë e dosjes dhe çdo OE ofertues duhet ti përmbahet sqarimeve të dosjes së tenderit. Ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Pretendimi ankimor 2. AK në njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës ka cekur arsyetimin një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Ky konstatim nuk qëndron siç e cekem më lart pas njoftimit mbi vendim ku kompania jonë është shpallur fitues nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP e cila do të rezultonte në anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim AK ka cekur se ky ka qen gabim teknik pasi qe aktiviteti i prokurimit është anuluar me arsyetimin: Një shkellje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhte dhe nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një ndryshimi .

OE ankues pretendon se AK-zyra e prokurimit ka kërkuar informacione shtesë dhe ne ju kemi dërguar të gjitha sqarimet, ne rast se ka pasur dilema se a do të realizojmë projektin sipas plotësimit /ndryshimit të bere në dosjen e tenderit ka munduar të na drejtohet me letër standarde se a do të përmbahemi në implementim ndryshimeve në dosjen e tenderit. Tutje OE ankues shton se ne pas kalimit të afati për ankesë me dt.04.04.25, kemi porositur blerje një pjesë të lëndës së pare jashtë vendit në mënyrë që të përgatitemi për realizimin e projektit me kohë anulimi i aktivitetit në këtë fazë është diskriminim ndaj kompanisë sonë dhe dëmtim financiar duke na pamundësuar fitimin e pritur nga kjo kontratë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se AK fillimisht kishte rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik “Agimi-DE” Sh.p.k. Deçan, tani ankues. Më datë 10.04.2025 AK përmes “Njoftimit për anulim e dhënies së kontratës” e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin:

“Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit për “Furnizim me kuti arkivuese” me nr. të prokurimit: 632-25-814-1-2-1. Pas hapjes dy operator ekonomik kanë kërkuar sqarime shtesë AK me dt.15.02.2025, ka bërë sqarimet shtesë të cilat i ka ngarkuar ne platformën e-prokurimit, por nuk ka ngarkuar edhe përmirësimin e përshkrimit të çmimit. Te gjithë operatorët ekonomik ofertues kanë ofertuar me përshkrimin e vjetër të çmimeve, kurse AK këtë e ka vërejtur pas publikimit të njoftimit për dhënie (B58). Në këtë pikë AK është detyruar të beje anulimin e dhënies (B58) si e vetmja mundësi. “ Lidhur me pretendimin e OE ankues se arsyeja për anulim është e jashtëligjshme dhe në kundërshtim me LPP-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se Autoriteti Kontraktues përderisa ka leshura një gabimi të tillë duke mos ..”ngarkuar edhe përmirësimin e përshkrimit të çmimit” dhe këtë gabim “e ka vërejtur pas publikimit të njoftimit për dhënie (B58)” siç theksohet edhe në njoftim mbi anulimin nga AK-së, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit do duhet të anulohet, për faktin se paramasa është dokument thelbësorë me të cilin do të përgatisin ofertën operatorët ekonomik dhe mbi bazën e te cilit do të implementohet kontrata. Si rrjedhojë, përgjegjësia për këtë situatë nuk i atribuohet operatorit ekonomik ankues, por lidhet me papërgjegjshmërinë/neglizhencën e autoritetit kontraktues. Prandaj, në kuptim të nenit 62 të LPP-së konkretisht pika 1.1 ky aktivitet i prokurimit anulohet.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se anulimi i aktivitetit të prokurimit në këtë fazë (pas hapjes së ofertave dhe njoftimit për dhënie të kontratës), si rezultat i neglizhencës ose papërgjegjshmërisë së zyrtarit përgjegjës të prokurimit, klasifikohet si shkelje e dispozitave të LPP-së, dhe përbën bazë për revokimin e certifikatës, në përputhje me nenin 95 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Lidhur me pretendimin se Autoriteti Kontraktues si arsye për anulimin ka përmendur një urdhër të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, i cili kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK ka sqaruar se ka ndodhur një gabim teknik dhe se kjo nuk është arsyeja e anulimit të aktivitetit të prokurimit. Ndërsa sa i përket pretendimit se “pas kalimit të afatit për ankesë më datë 04.04.2025, kemi porositur blerjen e një pjese të lëndës së parë jashtë vendit në mënyrë që të përgatitemi për realizimin e projektit në kohë”, ekspertja shqyrtuese sqaron se njoftimi për dhënie të kontratës nuk përbën kontratë të nënshkruar dhe rrjedhimisht nuk krijon obligime juridike ndërmjet palëve. Në këtë kontekst, çdo veprim i ndërmarrë nga operatori ekonomik ankues për blerjen e një pjese të lëndës së parë siç theksohet ankuesi, para nënshkrimit të kontratës, është veprim në rrezik të tij dhe nuk mund të konsiderohet bazë për kompensim.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjakovës, të mbajë në fuqi njoftimin për anulim të datës 10.04.2025, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar për arsye të cilën e kemi dhen në përgjigje të pretendimit numër një.

–Gjetjet e Panelit Shqyrtues–

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘Furnizim me kuti arkivuse’, me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1, e inicuar (AK) - Komuna e Gjakovës

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserishte e bazuar për faktin vet AK-Komuna e Gjakovës fillimisht ka shpërblyer me kontratë sipas B08 Njoftimit për dhënie të kontratës OE ankues me datën 08.04.2025 ku më pastaj ka Publikuar B11 Njoftimi për anulimin e dhenies së kontratës data 10.04.2025.

Paneli shqyrtues pasi ka vërejtur se njera nga arsyet kryesore të anulimit të këtij aktiviteti nga AK-ja sipas B11 Njoftimi për anulimin e dhenies së kontratës citoj “Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit për “Furnizimi me kuti arkivuese”, me numër identifikues 632-25-814-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-25-007-121 .Para hapjes, dy Operator kanë kërkuar sqarime shtesë. autoriteti kontraktues me dt.15.02.2025, ka bërë sqarimet shtesë të cilat i ka ngarkuar në platformën e e-prokurimit, por nuk ka ngarkuar edhe përmirësimin e përshkrimit të çmimit. Të gjithë Operatorët ekonomik kanë ofertuar me përshkrimin e vjetër të çmimeve, kurse Autoriteti kontraktues këtë e ka vërejtur pas publikimit të Njoftimit për dhënie(B08). Në këtë pikë, Autoriteti kontraktues është detyruar të bëjë anulimin e dhenies(B08) si e vetmja mundësi”. P.SH vëren se tek formularti ka përshkrimin ‘ IV.4) *Arsyeja e anulimit të njoftimit të dhënies së kontratës: x Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit*” x *Anulim dhe Ri-tenderim i aktivitetit të prokurimit*

Ndonëse sikurse parashihet në nenin 26 paragrafi 1 dhe 2- Nënshkrimi i kontratave publike i LPP, neni 62 paragrafi 1 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i LPP-së dhe neni 43.5.i, të Rregullores për Prokurimin Publik nr.01/2022, nuk janë interpretuar mbi bazën e provës materiale të AK, Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. ; " prokurimit 632-25-814-1-2-1, ", dhe është nxjerr rekomandim i pabazuar me ligjin e LPP-se. Andaj Paneli Shqyrtues përfundimisht nuk mund ta marr si një fakt të mirëqene dhe nuk ja falë besimin e provës në këtë çështje administrative.

Sikurse kjo procedurë e cila është inicuar sipas nenin 42.4 i RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, e obligon AK që, citat: "Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues publikon B05 Njoftim mbi dhënie të kontratës e më pastaj obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Përdersa AK-ja në B11 Njoftimi për anulimin e dhenies së kontratës ka ofruar të dhëna të pa sakta dhe jo reale lidhur me arsyetimin për anulimin e procedurës së prokurimit ngase për këtë procedurë nuk ka asnjë urdhër të lëshuar nga OSHP-ja, Paneli Shqyrtues i shqipton vërejtje Autoritetit Kontraktues dhe në raste të përsëritjeve të tilla do të veprojë konform neni 105 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues vlerëson se çështja e anulimit të aktivitetit të prokurimit publike, nga ana e Autoriteteve kontraktuese është e rregulluar me legjislacion primar dhe sekondar. Ligji për Prokurim Publik , neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike, paragrafi 1 përcakton” Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti

kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual....”

Paragrafi 2 i ligjit përcakton” Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme”.

Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.1 i LPP, përcakton” 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Poashtu me legjislacionin sekondar, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, , përcakton” Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;”

Paneli shqyrtues vrenë se Autoriteti Kontraktues në B11 Njoftimi për anulimin e dhenies se kontrates e dates 10.04.2025 e ka arsyetuar, duke e cituar dispozitën ligjore të LPP, nenin 62 paragrafi 1 sipas Ligjit të Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, e po ashtu sikurse në përgjigjen në Kërkesën për Rishqyrtim siq parashihet në nenin 108/A të LPP-së dhëne informacione shtese për arsyen e anulimit të aktiviteti të prokurimit duke ofruar edhe sqarimin.

Paneli Shqyrtues përfundimisht konstaton se Autoriteti Kontraktues Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit e ka bazuar në përputhje me dispozitat ligjore të lartshënuara, nenin 26 paragrafi 1 dhe 2- Nënshkrimi i kontratave publike i LPP, nenin 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik nr.01/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr 002/2024, dispozita të cilat përcaktojnë rregullat e anulimit të aktivitetit të prokurimit nga Autoritet Kontraktuese.

Andaj Paneli Shqyrtues përfundimisht lidhur me ankesën e Operatorit ekonomik ‘Agimi-De SH.P.K ', të parashtruar kundër “B11 Njoftimi për anulimin e dhenies se kontrates” datës 10.04.2025 procedura e prokurimi me titull " 'Furnizim me kuti arkivuse", me numër të prokurimit 632-25-814-1-2-1, e inicuar (AK) - Komuna e Gjakovës " dhe Vendimit të datës 17.04.2025 ‘për refuzimin e Kërkesa për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues , ka vendosur në konsistencë me vendimet e OSHP-së që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi , B11 Njoftimi për anulimin e dhenies se kontrates, siq parashihet në nenin 26, paragrafi 2, dhe nenin 62 i LPP.

Paneli shqyrtues lidhur me këtë çështje bënë me dije se nuk ka autorizime ligjore në këtë fazë dhe për këtë nuk mund ta obligoj asnjë autoritet kontraktues që të bëjë nënshkrimin e kontratës. Megjithatë, ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit të aktivitetit të prokurimit mund ti drejtohet Gjykatës kompetente për mbrojtën e te drejtave të tij/saj.

Paneli shqyrtues përfundimisht, bazuar në të lartcekurat dhe me qëllim që kjo lëndë mos ta humb qëllimin në kuptim të nenit 1 të LPP, dhe duke marrë parasysh të gjitha veprimet e palëve në procedurë të shpjeguara në mënyrë konkrete, vendos që ankesa të kualifikohet si pjesërisht e bazuar dhe ti jep të drejtën AK që të lenë në fuqi vendimin e saj, ngase thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret në mungesë të mjeteve bugjetore ka pasurit të drejtë të vendosin anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore. Paneli Shqyrtues i bënë me dije AK-se që në të ardhmën do ta bëjë monitorimin lidhur me këtë aktivitet.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, Paneli shqyrtues, konform nenit 30, në emër të dëmit, për kompensimin e shpenzimeve procedurale, OE ankues, "Agimi-De SH.P.K., të paguajë vlerën e përcaktuar sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe vendosi sipas dispozitave ligjore të lartcekura, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjesërishtëm të ankesës të OE "Agimi-De " SH.P.K. vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - AGIMI DE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: